



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2667 prot. datë 10.5.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 83057 prot. datë 21.5.2021

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 88, datë 10.5.2021

**PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2021 – 2022
NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J M Ë:

Struktura e vitit shkollor 2021 - 2022 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
 - a) Mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 8 qershor 2022.
 - b) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - c) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 9 - 30 qershor 2022.
2. Në arsimin e mesëm të lartë:
 - a) Mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 15 qershor 2022.
 - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 1 qershor 2022.
 - c) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - c) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2 - 30 qershor 2022.
3. Në arsimin profesional:
 - a) Mësimet fillojnë më 13 shtator 2021.
 - b) Nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2 si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare përfundojnë mësimet më 15 qershor 2022.
 - c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2 përfundojnë mësimet më 1 qershor 2022.
 - ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 20 maj 2022.
 - d) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit II dhe III të KShK-së zhvillohen në periudhën 1 - 15 qershor 2022.

- e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të Nivelit IV të KShK-së zhvillohen në periudhën 26 maj - 1 qershor 2022.
- f) Provimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 2 - 30 qershor 2022.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT

SPORTIT DHE RINISË

EVIS KUSHI



MINISTRI I FINANCEVE

DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

